

RAPORTI VJETOR 2012



ANNUAL REPORT 2012

PËRMBAJTJA

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Letër nga Drejtori Ekzekutiv | 3 |
| Për ATRC | 4 |
| Misioni | 5 |
| Partnerët | 6 |
| Përkrahësit | 7 |
| Programi për trajnime dhe ngritje kapacitetesh..... | 8 |
| Konsulentat individuale | 9 |
| Programi për menaxhim të granteve | 10 |
| Programi për avokim | 11 |
| Monitorimi i procesit të kthimit të zhvendosurve nga vendet e treta | 12 |
| Qytetarë aktiv-komuna të përgjegjshme dhe transparente..... | 13 |
| Drejtësia dhe Qytetarët..... | 14 |
| Synergy for Energy Awareness in SEE..... | 16 |
| Debate Publike pas-zgjedhore me kryetaret e komunave..... | 17 |
| Mekanizmat për qytetari aktive..... | 18 |
| Zgjerimi i BE-së, transformimi i sektorit të mjedisit dhe energjisë në | |
| Kosovë roli shoqërisë civile | 19 |
| Reforma Zgjedhore 2012 | 20 |
| Programi për informim, Shtypi për ATRC-në | 21 |
| Raporti Financiar | 22 |
| Botimet e ATRC-së | 23 |
| Bordi i ATRC-së | 24 |
| Stafi i ATRC-së | 24 |

LETËR NGA DREJTORI EKZEKUTIV

Të nderuar partnerë,

Të nderuar partnerë,

ATRC, edhe këtë vit del para jush me përmbledhjen vjetore të punës dhe aktivitetit të saj, duke vazhduar kështu traditën e saj të nisur, të komunikimit dhe informimit të publikut të gjerë dhe me Ju të nderuar partnerë.

Raporti vjetor për vitin 2012 është një pasqyrim i aktiviteteve të shumta, të nduar-ndurshme, të zbatuara nga ATRC, aktivitete këto të cilat janë komplementare dhe përplotësuese me programet kryesore të ATRC-së. Raporti vjetor përmban informacione të përgjithshme në lidhje me projektet e zbatuara, partneritetet e ndërtuara në nivel lokal dhe rajonal, trajnimet e mbajtura, konsulencat e ofruara, fushatat avokuese të organizuara, si dhe informata në lidhje me publikimet e prodhuara gjatë vitit 2012.

Informatat e ofruara në raport I kontribuojnë jo vetëm rritjes dhe forcimit të komunikimit me organizata tjera partnere vendore dhe ndërkombëtare, rritjes së transparencës së punës së saj, por edhe shkëmbimit të përvojave dhe praktikave në: fushën ngritjes së kapaciteteve për organizata joqeveritare dhe të tjerë, procesin e administrimit të granteve, ofrimit të shërbimeve bazuar në kërkesat e përfituesve, zbatimin e projekteve avokuese në nivele lokal dhe nacional, organizimin e debateve etj, fusha në të cilat ATRC ka kontribuar në vazhdimësi dhe do të vazhdojë të kontribuuar edhe në periudhën në vazhdim.

Viti 2012 me të drejte vlerësohet si vit i konsolidimit të mëtejshëm të ATRC-se, si viti i rritjes, i zgjerimit të partneriteteve nacionale dhe rajonale, i forcimit të partneriteteve dhe bashkëpunimit me institucione lokale dhe nacionale në Kosovë, vit i forcimit të imazhit të saj para qytetareve dhe para grupeve të cilave ajo u shërben etj. Rreth 70 trajnime dhe konsulencat e organizuara, me shume se 40 punëtorë të organizuara në tema dhe çështje të ndryshme, 32 debate pas zgjedhore të organizuara në 32 komuna të Kosovës, 7 debate të organizuara në 7 qendrat me të mëdha të Kosovës, me mijëra pjesëmarrës në aktivitetet e zhvilluara, janë vetëm disa nga dëshmitë të cilat vërtetojnë suksesin e ATRC-së brenda këtij viti raportues.

Serioziteti, përkushtimi dhe profesionalizmi i stafit të ATRC-së në zbatimin e detyrave dhe projekteve të nisura, i ka ndihmuar ATRC-së që të zgjerojë dhe rrisë angazhimet e saja në nivel vendi dhe rajoni, përmes zgjerimit të partneriteteve rajonale me organizata të Shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë.

Me respekt,
Kushtrim Kaloshi
Drejtor Ekzekutiv



PËR ATRC

Që nga themelimi i saj në vitin 2001, ATRC ka ndihmuar OJQ-të Kosovare në profesionalizimin e punës së tyre, artikulumin e kërkesave të tyre dhe ka avokuar tek strukturat qeveritare për çështje me rëndësi për shoqërinë Kosovare.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes katër programeve kryesore të saj:

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të ngris kapacitetet e organizatave joqeveritare në Kosovë në fushën e zhvillimit organizativ, menaxhimit të projekteve dhe në avokim.

2. Programi i administrimit të Granteve, i cili synon të ndihmoj organizatat joqeveritare lokale përmes granteve, duke synuar ndryshime të politikave publike, inicim të ligjeve dhe rregulloreve, praktika të reja në të mirë të publikut, fushata edukimi dhe sensibilizimi për çështje të ndryshme si: mjedisi, të drejtat e pakicave, transparenca dhe llogaridhënia etj.

3. Programi për Avokim- ATRC në partneritet me

organizata tjera në vazhdimësi inicim fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional, duke synuar që problemet e indentifikuara në komunitet t'i kthej në çështje të forta avokimi dhe si rezultat t'i gjej zgjidhjen e merituar.

4. Programi për Informim, mbështet shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve. Këtë e realizon përmes diskutimeve publike, konferencave, prezantimeve të donatorëve, publikimeve dhe uebfaqes së ATRC-së.

ATRC beson se ndërtimi i koalicioneve dhe partneriteteve ndërsektorale janë shtylla kyçe për arritjen e qëllimit dhe përmbushjen e misionit të saj. Për këtë arsye, ATRC është në bashkëpunim të vazhdueshëm me OJQ të shumta në Kosovë, është pjesë e fushatave avokuese që kanë për qëllim zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe është pjesë e rrjeteve në nivel lokal, regjional e ndërkombëtar.



MISIONI

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) është organizatë jofitimprurëse Kosovare e cila angazhohet për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendim-marrje, si kusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike dhe stabile rajonale.

ATRC ndihmon në forcimin e rolit të OJQ-ve si agjent të ndryshimit në shoqëri, ngritë kapacitetin e OJQ-

ve dhe iniciativave qytetare që të ndërrmarin fushata avokimi dhe kontribuon në krijimin e institucioneve qeverisëse bazuar ne standardet ndërkombëtare.

ATRC punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativat qytetare, administratën publike dhe me institucionet politike pa dallim feje, gjinie, etnie, moshe, aftësie, përkatësie politike dhe orientimi seksual.

PARTNERËT

Gjatë vitit 2012 ATRC ka vazhduar bashkëpunimin me organizata e institucione të ndryshme qeveritare në nivele lokale dhe nacionale, me organizata joqeveritare Kosovare dhe ndërkombëtare, në inicimin dhe implementimin e projekteve të përbashkëta.

Institucionet dhe agjencitë qeveritare me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2012:

- Të gjitha Komunitatet e Kosovës
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)
- Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)
- Zyra e Prokurorit Disiplinor (KPD)
- Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)
- Policia e Kosovës (PK)
- Zyra e Avokatit të Popullit
- Gjykatat e Qarkut dhe Gjykatat Komunale të 20 Komunave të Kosovës
- Zyrat regionale të DMNV-së (Divizionit për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave)
- Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministrisë së Drejtësisë

Organizatat joqeveritare rajonale me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2012:

- World Wild Fund for Nature (WWF) – Rome, Itali
- SEE Change Net – Sarajeve. Bosnia and Herzegovina
- Qendra EDEN, Tirana, Shqipëri
- Fractal, Belgrade, Serbia
- Qendra për Mjedis / Center for Environment, Banja Luka, Bosnje dhe Hercegovine
- Society for Sustainable Development Design, Zagreb, Kroaci
- Analytica, Shkup, Maqedoni
- Green Home, Podgoricë, Mali i Zi
- Forumi Evropian Mjedisor / EU Environment Forum

Organizatat Joqeveritare lokale me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2012:

- Rrjeti i Gazetarisë Hulumtuese në Kosovë (BIRN) - Prishtinë
- Instituti për Studime të Avancuara (GAP) - Prishtinë
- Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) - Prishtinë
- Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) – Prishtinë/Prizren
- Shoqëria e avokatëve “Sejdiu & Qerkini,” sh.p.k. – Prishtinë
- Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) - Prishtinë
- Oda e Avokatëve (OAK) - Prishtinë
- Syri i Vizionit- Pejë
- Civil Rights Program in Kosovo (CRP/K)-Prishtinë
- Internews Kosova- Prishtinë
- Balkan Sunflowers Kosova – Prishtinë
- Qendra Juridike e Kosovës (KLC)- Prishtinë
- Rrjeti Rinor i Kosovës (KYN)- Prishtinë
- Qendra për Politika dhe Avokim (QPA) - Prishtinë
- Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF)- Prishtinë
- Komunikimi për Zhvillim Social (CSD) - Gracanicë
- Proactive - Kamenicë
- Ekovision – Podujevë
- Shoqata Intelektualëve Pavarur (SHIP)- Deçan
- Elita – Viti
- Agro Eco – Gjilan
- Iniciativa Qyetetare - Obiliq
- Asociacioni i të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut (YAHR)- Lipjan
- IRP- Ferizaj
- Bethany Christian Services (BCS) - Gjakovë
- Iniciativa 6 - Prizren
- Shoqata e të Verbërve dhe me të Pamë të Dobësuar të Kosovës (ShVPDK)– Prishtinë



PËRKRAHËSIT

Përkrahësit e ATRC-së gjatë vitit 2012 kanë qenë:

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, <http://pristina.usembassy.gov>

Grupi i së Drejtës dhe Politikave Ndërkombëtare Publike (PILPG) www.justiceandthepeople.org

Agjensioni i Suedisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) www.sida.se

Qendra Ndërkombëtare Olof Palme www.palmecenter.org

Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) <http://www.unhcr.org>;

The Balkan Trust for Democracy-BTD <http://www.gmfus.org/balkantrust/>

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG - FES www.fes-prishtina.org

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE) www.osce.org



PROGRAMI PËR TRAJNIME DHE NGRITJE KAPACITETESH

Ky program ka për qëllim t'ju ofroj OJQ-ve metodat dhe mjetet e duhura për të iniciuar ndryshime në komunitetet e tyre. Dita ditës këto organizata ballafaqohen me sfida të reja dhe nevojat e tyre nuk janë të njëjta

si më parë, andaj edhe ATRC në vazhdimësi ndryshon programin e saj duke prezantuar trajnime më të avancuara dhe me tema të reja, në mënyrë që nevojat e përfituesve të saj të reflektohen në këtë program.

Gjatë vitit 2012, trajnerët e ATRC-së, në kuadër të projekteve, kanë realizuar 34 trajnime dhe punëtori, nga të cilat kanë përfituar OJQ, qytetarë dhe institucione të ndryshme. Gjithashtu, ATRC ka realizuar edhe 12 trajnime në përputhje me kërkesat e Save the Children në Kosovë, OSBE, International Organization for Migration (IOM) dhe Ballkan Sunflowers.

Temat e përfshira në Programin e trajnimeve:

- Dizajnimi i Projekt Propozimit
- Menaxhimi i Ciklit të Projektit
- Menaxhimi i OJQ-ve dhe Ngritja e fondeve
- Avokimi dhe Ndërtimi i Koalicioneve
- Roli i OJQ-ve në Shoqërinë Civile
- Qeverisja e Mirë
- Lidërshipi dhe Menaxhimi
- Planifikimi Strategjik
- Monitorimi dhe Vlerësimi

- Marrëdhëniet Ndërmjet OJQ-ve dhe Mediave
- Komunikimi Efektiv
- Komunikimi me Klient
- Menaxhimi Bazik Financiar
- Marrëdhëniet me Publikun dhe Marketingu
- Menaxhimi i Konfliktëve
- Negociatat
- Qeverisja me Pjesëmarrje
- Planifikimi Kooperues
- Buxhetimi me Pjesëmarrje
- Infrastruktura ligjore që reflekton punën e komunave në Kosovë
- Mekanizmat e përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse
- Funksionimi i qeverisë lokale
- Planifikimi i projekteve në komunitet
- Barazia gjinore



KONSULENCAT INDIVIDUALE

Ndryshe nga trajnimet formale të cilat u dedikohen një audience më të madhe, konsulencat janë të dizajnuara për të adresuar nevojat specifike të individëve dhe organizatave në mënyrë të veçantë. Për këtë arsye, ATRC praktikon metodën e kombinimit të dy shërbimeve: trajnimet me konsulenca individuale, duke synuar të përmbush sa më mirë nevojat e çdo përfituesi dhe njëkohësisht për të ngritur efektivitetin e programit të saj.

Gjatë vitit 2012, janë zhvilluar 34 konsulenca individuale në çështje që kanë të bëjnë me shkrim të projekt propozimeve, zhvillim organizativ, menaxhim financiar, ngritje të fondeve, zgjidhje konflikti, ndërmjetësim etj.



PROGRAMI PËR MENAXHIM TË GRANTEVE

Përmes këtij programi ATRC ofron përkrahje financiare për organizatat joqeveritare lokale. ATRC përkrah projektet që përqendrohen kryesisht në fushata avokimi në nivele lokale dhe qendrore, duke synuar ndryshime të politikave publike, inicim të ligjeve dhe rregulloreve të reja lokale, praktika të reja në të mirë të publikut, fushata edukimi dhe sensibilizimi për çështje të ndryshme si: transparenca, llogaridhënia, mjedisi, të drejtat e pakicave etj.

Në këtë mënyrë ATRC synon të kontribuoj që shoqëria civile të jetë partner efektiv dhe me ndikim lidhur me vendimmarrjen publike, duke kontribuar për një Kosovë demokratike dhe gjithëpërfshirëse.

Nga viti 2005 deri tani ATRC ka administruar 157 grante me vlerë prej 5 000-50 000 dollarë.

Programi për menaxhimin e granteve është mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në kuadër të Programit për Shoqëri Civile (KCSP), i menaxhuar nga Bordi për Hulumtime dhe Shkëmbime Ndërkombëtare (IREX) dhe Programit për Forcimin e Shoqërisë Civile Kosovare (K-CSSP) i menaxhuar nga Instituti për Komunitetet të Qëndrueshme (ISC); Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe nga Ambasada e Holandës në Beograd përmes fushatës rajonale mjedisore: Lëvizja Bells.



“Bringing out the advocate in everyone”

PROGRAMI PËR AVOKIM

Për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në zhvillimin e institucioneve dhe praktikave demokratike, ATRC në partneritet me organizata tjera dhe e vetme, në vazhdimësi inicion fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional, duke synuar që problemet e indentifikuara në komunitet t'i kthej në çështje të forta avokimi dhe si rezultat t'i gjej zgjidhjen e merituar. Programi për avokim gjithashtu siguron një platformë për rrjetëzim, shkëmbim informatash dhe aktivizim me OJQ-të tjera nga Kosova dhe rajoni.

Gjatë vitit 2012, ATRC ka qenë e përfshirë në këto projekte:

- Qytetarë aktiv-Komuna të përgjegjshme dhe transparente
- Drejtësia dhe qytetarët
- Monitorimi i procesit të kthimit të zhvendosurve nga vendet e treta
- Mekanizmat për qytetari aktive
- Debate publike pas zgjedhore me kryetarët e komunave
- Reforma Zgjedhore 2012
- Synergy for Energy Awareness in SEE
- Zgjerimi i BE-së, transformimi i sektorit të mjedisit dhe energjisë në Kosovë- Roli i Shoqërisë Civile



MONITORIMI I PROCESIT TË KTHIMIT TË ZHVENDOSURVE NGA VENDET E TRETA

Gjatë vitit 2012, ATRC vazhdoi implementimin e projektit “Monitorimi i procesit të kthimit të të zhvendosurve nga Vendet e treta”, i cili financohet nga UNHCR. Projekti ka si objektiv monitorimin e procesit të kthimit të detyruar dhe vullnetar të azil kërkuesve Kosovar nga vendet e treta në Kosovë.

Përmes këtij projekti, ekipi monitorues i ATRC-së arrin të identifikojë të gjitha rastet, të cilat janë kthyer në mënyrë të detyruar apo vullnetare, duke përcjellur në vazhdimësi trendet e të kthyerve në Kosovë dhe qëndrueshmërinë e këtyre kthimeve.

Ekipi i monitoruesve të ATRC edhe gjatë vitit 2012 është vizituar nga përfaqësuesit e zyrës së UNHCR, të cilët shprehën interesin e tyre në lidhje me punën dhe angazhimet e stafit të ATRC-së në monitorimin e procesit të kthimit të të zhvendosurve në përgjithësi si dhe angazhimet dhe përkujdesjen që personat e kthyer marrin nga institucionet relevante pas kthimit në Kosovë në veçanti.



QYTETARË AKTIV - KOMUNA TË PËRGJEGJSHME DHE TRANSPARENTE

Nga janari i vitit 2012 ATRC ka filluar implementimin e projektit “Qytetarë aktiv-komuna të përgjegjshme dhe transparente”, i cili synon të rris pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal. Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar një sërë aktivitete, duke filluar me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me katër komunat në të cilat implementohet projekti: Gjilan, Viti, Kamenicë dhe Novobërdë. Këto marrëveshje bashkëpunimi u realizuan gjatë takimeve që ATRC zhvilloi me kryetarët e komunave të lartpërmendura me ç’rast të dy palët u pajtuan që të bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet në forcimin e bashkëpunimit në mes Komunave dhe qytetarëve.

Projekti ka vazhduar me themelimin e 20 grupeve joformale avokuese dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre. ATRC ka zhvilluar 20 punëtori dhe 12 trajnime për përfaqësuesit e grupeve joformale, të përqëndruara në rolin e qytetarëve në qeverisjen lokale, mekanizmat e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal, avokim dhe dizajnim të projekteve me iniciativë të ko-

munitetit. Me qëllim të inicimit të praktikave të qëndrueshme dhe efektive në mes qytetarëve dhe komunave të tyre ATRC ka publikuar edhe udhëzuesin “Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje në nivel lokal”.

Në kuadër të këtij projekti është zhvilluar edhe një vizitë studimore në Suedi, në të cilën morën pjesë Drejtori i ATRC-së z.Kushtrim Kaloshi dhe Drejtori i Drejtorisë për buxhet dhe financa i Komunës së Gjilanit z. Nuhi Nuhiu. Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimi i eksperiencave dhe bartja e praktikave të mira në Kosovë rreth përfshirjes së qytetarëve në qeverisjen lokale.

ATRC edhe gjatë vitit të ardhshëm do të vazhdojë me organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në mes qytetarëve dhe zyrtarëve komunal, me qëllim të aplikimit të mekanizmave të qeverisjes me pjesëmarrje në nivel lokal.

Ky projekt mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme.

DREJTËSIA DHE QYTETARËT

Kampanja “Drejtësia dhe qytetarët”, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit – Zyra ndërkom-bëtare e Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit, është një lëvizje që sjell së bashku qytetarët dhe grupet e shoqërisë civile me qëllim të identifikimit të çështjeve konkrete në sistemin e drejtësisë dhe promovimin e ndryshimeve përmes avokimit publik. Qëllimi i kampanjës është që të promovojmë një qeveri më të përgjegjshme dhe të rrisim përgjegjshmërinë e sistemit të drejtësisë ndaj nevojave të qytetarëve.

ATRC, në cilësinë e partnerit implementues, së bashku me Grupin e së Drejtës dhe Politikave Ndërkombëtare Publike (PILPG) gjatë këtij viti kanë organizuar 20 Punëtori për informim publik për Mekanizmat e ankesave për sistemin e drejtësisë që janë në dispozicion për qytetarët. Qëllimi i mbajtjes së punëtorive ishte informimi i qytetarëve për mekanizmat e ankesave në sistemin e drejtësisë për: gjyqtarët, prokurorët, policinë, dhe avokatët. Seria e parë e këtyre punëtorive u mbajt gjatë muajit mars në 10 komuna të Kosovës: Obiliq, Podujevë, Lipjan, Suharekë, Novobërdë, Deçan, Istog, Malishevë, Viti dhe Shtërpce. Kurse, gjatë muajit qershor ATRC vazhdoi serinë e dytë të punëtorive edhe në 10 komuna tjera të

Kosovës: Mitrovicë, Gjakovë, Prizren, Mamushë, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Drenas,


Gracanicë dhe Kamenicë. Për të sqaruar infrastrukturën ligjore ekzistuese në Kosovë, me theks të veçantë mekanizmat e ankesave të parapara me ligj, ATRC në këto punëtori siguroi pjesëmarrjen nga institucionet relevante, si: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Gjykatat Komunale, Gjykatat komunale për kundërvajtje, Zyra e Prokurorit Disiplinor, Oda e Avokatëve, Avokatët e viktimave, Këshillat Lokale për Siguri në Komunitet, Organizata Clard dhe përfaqësues nga Kampanja Drejtësia dhe Qytetarët. Në të gjitha takimet e organizuara, qytetarët vlerësuan shumë pozitive idenë e organizimit të takimeve të tilla informuese, meqë shpesh në mungesë të informacionit dhe njohurive, qyte-

tarët të cilët janë ballafaquar me trajtime jo të mira në gjithë sistemin e drejtësisë, nuk kanë përdorur mekanizmin e ankesës.

Është vlerësuar gjithashtu në pothuajse të gjitha takimet e organizuara, se është hera e parë që në një takim të tillë janë bashkë përfaqësues të gjykatave, prokurorisë, policisë, avokatëve, OJQ-ve, etj.

Në kuadër të Kampanjës Drejtësia dhe Qytetarët ATRC dhe PILPG më 28 dhe 29 mars organizuan edhe dy sesione trajnimiti, në Gjakovë dhe në Prizren. Qëllimi i këtyre punëtorive ishte ngritja e kapaciteteve avokuese të përfaqësuesve të OSHC-ve nga regjioni i Gjakovës dhe Prizrenit në çështje që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit në përgjithësi, hartimin e rekomandimeve për politikën, negociimin me zyrtarët qeveritar si dhe shkëmbim idesh dhe eksperiencash në çështjet e avokimit në Kosovë.

Gjithashtu, ATRC ka përgatitur dhe publikuar doracakun Avokimi në Kosovë. Doracakun përmban informata të rëndësishme për zhvillimin e avokimit në Kosovë, si; definicioni dhe konceptet e avokimit; zhvillimi i një fushate avokimi; informacione rreth tri shtyllave të Shtetit në Kosovë: legjislativit, ekzekutivit, gjyqësorit; informata rreth qeverisjes lokale; pjesëmarrja e individëve dhe OJQ-ve në nivelin lokal; si mund qytetarët të kenë qasje në një dokument publik; si të ankoheni kur nuk ju është lejuar qasja në një dokument publik; si mund të ndikojnë qytetarët në partitë politike dhe përfaqësuesit e zgjedhur; si mund të ndikojnë qytetarët në fazën e parë të inicimit të ligjeve nga qeveria e Kosovës; kush janë institucionet ligjore kryesore në nivel qendror dhe lokal; rëndësia e parnteritetit në mes të OJQ-ve dhe institucioneve në procesin e reformave; shembuj nga fushata të suksesshme avokuese në Kosovë, etj.



PETICION: “KËRKOJMË NGA KËSHILLI GJYQËSOR DHE KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS QË TË PUBLIKOJ EMRAT E ZYRTARËVE TË CILËT JANË GJETUR FAJTOR PËR KORRUPSION DHE SJELLJE TJERA TË PAHIJSHME”

Në kuadër të Kampanjës Drejtësia dhe Qytetarët, ATRC dhe PILPG gjatë muajit shtator filluan aksionin për mbledhjen e nënshkrimeve nga qytetarët duke kërkuar nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës që të publikohen emrat e zyrtarëve, të cilët janë gjetur fajtor për korrupsion dhe sjellje të pahijshme. Peticioni u zhvilluar në qendër të Prishtinës, më 26, 27 dhe 28 shtator. Gjatë këtyre ditëve peticionin e nënshkruan mbi 1 200 qytetarë.



SYNERGY FOR ENERGY AWARENESS IN SEE

SYNERGY FOR ENERGY AWARENESS IN SEE

ATRC në rolin e partnerit implementues për Kosovë dhe gjashtë organizata të gjashtë shteteve të regionit implementojnë projektin Synergy for Energy Awareness in SEE Region. Përmes këtij projektit, organizatat partnere synojnë të bëjnë presion tek qeveritë e vendeve respektive që të orientojnë zhvillimin en-

ergjetik në vend sipas standardeve evropiane, duke i dhënë prioritet prodhimittë energjisë alternative ose me sa më pak ndotje në mjedis.





DEBATE PUBLIKE PAS ZGJEDHORE ME KRYETARËT E KOMUNAVE

ATRC në bashkëpunim me BIRN dhe GAP, gjatë muajve maj-qershor, kanë organizuar debate pas zgjedhore me 32 kryetarët e 32 komunave të Kosovës. Qytetarë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, parti politike dhe media, pjesëmarrës në debatet publike, kanë patur rastin që të njihen me sukseset, të arriturat dhe sfidat në përmbushjen e premtimeve të dhëna nga kryetari i komunës së tyre gjatë zgjedhjeve të fundit lokale. Ndër çështjet kryesore të diskutuara me kryetarët e komunave ishin: rezultatet e arritura në komuna, hapat kryesor në identifikimin dhe përfshirjen e nevojave dhe rekomandimeve të qytetarëve në buxhetin

komunal dhe mekanizmat e komunikimit dhe konsultimit me qytetarë.

Rreth 4,010 qytetarë gjatë këtyre debateve kanë shfrytëzuar mundësinë që drejtpërsëdrejti të diskutojnë me kryetarin e komunës së tyre rreth problemeve dhe çështjeve me të cilat ata ballafaqohen. Problemet kryesore të ngritura nga qytetarët u fokusuan rreth korrupsionit, ndërtimeve ilegale dhe papunësisë. Debatet e organizuara nga ATRC janë mbështetur nga FRIEDRICH EBERT STIFTUNG – FES.



MEKANIZMAT PËR QYTETARI AKTIVE

Nga muaji shkurt 2012 ATRC filloi implementimin e projektit “Mekanizmat për qytetari aktive”, të përkrahur nga The Balkan Trust for Democracy. Përmes këtij projekti ATRC ka synuar të rris efektivitetin, llogaridhënien dhe përgjegjësinë e komunave në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Projekti ka përfshirë një sërë aktivitete, duke filluar nga organizimi i takimeve me qytetarë dhe zyrtarë komunal, analizën dhe hulumtimin rreth funksionimit të nënstrukturave komunale, duke vazhduar më pas me organizimin e tryezave dhe lobimin dhe avokimin tek institucionet përgjegjëse për marrjen në konsideratë të rekomandimeve të qytetarëve rreth funksionimit të nënstrukturave komunale që janë në shërbim të qytetarëve.

Në të gjitha takimet e mbajtura me qytetarë është vlerësuar e domosdoshme themelimi ose rifunksionalizimi i nënstrukturave komunale në shërbim të qytetarëve, duke i konsideruar ato si një ndër mekanizmat shumë të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve më të shpejta dhe më efikase për qytetarët. Gjithashtu, themelimi ose rifunksionalizimi i këshillave lokale është konsideruar si një mjet efikas për rritjen e komunikimit të

qytetarëve me zyrtarët komunal si dhe informimin e tyre rreth çështjeve të ndryshme.

Rezultatet e dala nga analiza rreth funksionimit të nënstrukturave komunale që janë në shërbim të qytetarëve, e cila ka përfshirë 33 komuna të Kosovës, tregojnë se vetëm në disa komuna të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Kamenicë, Mitrovicë, Drenas dhe Skenderaj vazhdojnë të funksionojnë nënstrukturat komunale.

Ndërkohë, Udhëzimi administrativ Nr.2008/08 “Për Marrëveshjet e bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane” obligon Komunitat që me Statut dhe rregullore lokale të përcaktojnë strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, si dhe mënyrën, kohën, numrin dhe çështje tjera që lidhen me zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane. ATRC do të vazhdojë të avokoj te institucionet në nivel lokal dhe qendror për themelimin e Këshillave lokale, të parapara me Udhëzimin administrativ.





ZGJERIMI I BE-SË, TRANSFORMIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT DHE ENERGJISË NË KOSOVË ROLI I SHOQËRISË CIVILE

Forumi Mjedisor (FM) është një projekt i financuar nga Komisioni Evropian, i cili synon të mbështesë OJQ-të në rolin e tyre aktiv dhe konstruktiv rreth procesit të zgjerimit në BE. Projekti bazohet në Dialogun e mëparshëm të OJQ-ve dhe Forumit të ri të OJQ-ve të cilat ishin të fokusuar në çështjet e shkëmbimit të in-

formacionit dhe përmirësimit të transparencës në mes të OJQ-ve dhe Komisionit. Një nga qëllimet e forumit është që të zhvilloj kapacitetet e OJQ-ve avokuese për të krijuar një dialog konstruktiv me autoritetet kombëtare.

ZGJERIMI I BE-SË, TRANSFORMIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT
DHE ENERGJISË NË KOSOVË ROLI I SHOQËRISË CIVILE



REFORMA ZGJEDHORE 2012

Me qëllim të infomimit të qytetarëve të komunave të Kosovës në lidhje me procesin e Reformës zgjedhore në Kosovë, në veçanti diskutimin e rekomandimeve, propozimeve dhe kërkesave të qytetarëve, ATRC në partneritet me KIPRED, gjatë muajve shkurt-mars 2012 kanë organizuar takime informative me qytetarë në 7 komuna të Kosovës: Gjilan, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Prishtinë, Prizren dhe Ferizaj.

Përfaqësues të partive politike, përfaqësues nga Komisionet Komunale Zgjedhore, përfaqësues të organizatave joqeveritare, përfaqësues të mediave lokale, ekspert të zgjedhjeve dhe qytetarë, të cilët morën pjesë në takimet e organizuara, diskutuan në hollësi proceset e deritashme zgjedhore në Kosovë, duke u përqendruar më shumë në të metat dhe dobësitë e identifikuara si

dhe ofrimin e alternativave për përmirësimin e tyre në procesin e Reformës Zgjedhore 2012.

Ndarja e Kosovës në zona zgjedhore ka qenë tema bosht e takimeve publike, meqë në opinion janë diskutuar propozime të ndryshme për ndarjen e Kosovës në më shumë se një zonë zgjedhore. Rekomandimet dhe shqetësimet e qytetarëve përqendroheshin pothuajse në gjithë sistemin zgjedhor, me theks të veçantë në parandalimin e keqpërdorimit të votës si dhe rritjes së transparencës në procesin e numërimit të votave. Rekomandimet, propozimet dhe vërejtjet e qytetarëve nga 7 takimet e organizuara janë sistemuar në një dokument dhe më pas janë diskutuar me Komisionin për Reformën Zgjedhore të Kuvendit të Kosovës për inkorporimin e tyre në draftin final.



PROGRAMI PËR INFORMIM

Programi i ATRC-së për informim, mbështet shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve. Këtë e realizojnë përmes diskutimeve publike, konferencave, prezantimeve të donatorëve, publikimeve dhe uebfaqes së ATRC-së.

Buletini "Avokuesi"

ATRC vazhdon me publikimin e buletinit elektronik "Avokuesi", i cili përmban aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë periudhës tremujore. "Avokuesi" përcillet në mënyrë elektronike tek OJQ-të, mediat, institucionet qeveritare dhe lokale, partnerët dhe përkrahësit potencial brenda dhe jashtë Kosovës. "Avokuesi" mund të shkarkohet nga web faqja e ATRC: www.advocacy-center.org.

SHTYPI PËR ATRC-NË




Biblioteka

Biblioteka e ATRC-së posedon më shumë se 1.060 tituj librash, raportesh dhe materiale të tjera në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe për avokim, shoqëri civile, lidhshmëri, të drejtat e njeriut, vetëdijësim gjinor, etj. Për më shumë informata mund të hyni në web faqen e ATRC: www.advocacy-center.org.

Ueb faqja e ATRC

ATRC pasuron uebfaqen me informacione të reja, duke e bërë atë më të përshtatshme për shfrytëzuesit në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Në vitin 2011, uebfaqja është vizituar 21.087 herë.



PROGRAMI PËR INFORMIM / SHTYPI PËR ATRC-NË

RAPORTI FINANCIAR



INDEPENDENT AUDITORS' REPORT

To the Board of Directors of Advocacy Training and Resource Centre

We have audited the accompanying financial statements of Advocacy Training and Resource Centre (ATRC), which comprise the balance sheet as at December 31, 2012, and the statement of revenue and expenditure, statement of changes in net assets and cash flow statement for the year then ended, and other explanatory notes.

Management's Responsibility for the Financial Statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements in accordance with Kosovo Accounting Standards. This responsibility includes: designing, implementing and maintaining internal control relevant to the preparation and fair presentation of financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud or error; selecting and applying appropriate accounting policies; and making accounting estimates that are reasonable in the circumstances.

Auditor's Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on these financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance whether the financial statements are free from material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the financial statements. The procedures selected depend on the auditor's judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, the auditor considers internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the financial statements.

We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our audit opinion.

In our opinion, the financial statements referred to above present fairly, in all material respects, the financial position of ATRC as of December 31, 2012 and the results of its operation for the year then ended in conformity with accounting principals generally accepted in Kosovo.


Armend Osaj – Statutory Auditor

ACA – Audit & Consulting Associates

Prishtine, Kosovo

March 2013





PJESËMARRJA QYTETARE NË VENDIMMARRJE NË NIVEL LOKAL

BOTIMET E ATRC-SË

Avokimi në Kosovë

ATRC në kuadër të kampanjës: “Drejtësia dhe qytetarët” ka përgatitur dhe publikuar doracakun Avokimi në Kosovë. Doracaku përmban informata të rëndësishme për zhvillimin e avokimit në Kosovë. Doracaku i është shpërndarë falas organizatave, grupeve

formale dhe joformale avokuese, institucioneve publike etj.

Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje në nivel lokal

ATRC, në kuadër të projektit “Qytetarë aktiv-Komuna të përgjegjshme dhe transparente, i financuar nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme ka publikuar udhëzuesin Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje në nivel lokal.

Udhëzuesi përmban shembuj dhe rekomandime për

komunat, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët rreth përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Udhëzuesi i është shpërndarë falas zyrtarëve komunal dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Raporti vjetor 2011

ATRC ka përgatitur Raportin Vjetor 2011, i cili ju ofron përkrahësve, partnerëve dhe publikut pasqyrën e punës dhe aktivitetet e ATRC-së. Raporti përshkruan aktivitetet prej janarit deri në dhjetor të vitit 2011.

Të gjitha publikimet e ATRC mund të mirren në zyret e ATRC ose të shkarkohen nga web faqja e ATRC: www.advocacy-center.org.

BORDI I ATRC-SË

KRESHNIK BERISHA

Kryetar i Bordit

ADRIANA KABASHI

Nënkryetare e Bordit

VJOSA MULLATAHIRI

Anëtare e Bordit

Prof. Dr. ISA ELEZAJ

Anëtar Bordi

NAIM RASHITI

Anëtar Bordi

PERSONELI I ATRC-SË

Drejtor Ekzekutiv

Kushtrim Kaloshi

kushtrimk@advocacy-center.org

Drejtor i Programit

Donika Podrimja

donika@advocacy-center.org

Menaxher i Financave dhe Administratës

Gani Asllani

gani@advocacy-center.org

Menaxhere e Programit të Trajnimeve dhe
Konsulencave

Nora Susuri

nora@advocacy-center.org

Koordinatore e Projektit

Sanije Goxhufi

sanije@advocacy-center.org

Koordinatore e Ekipit për Monitorimin
e të Kthyerve

Emine Emini

emine_e@advocacy-center.org

Monitoruese

Magbule Pllana

magbule@advocacy-center.org

Monitorues

Hysen Hamzaj

hysen@advocacy-center.org

Monitorues

Zaid Kulinxha

zaid@advocacy-center.org

TI & Administratë

Arsim Kosumi

arsim@advocacy-center.org

Praktikant/e

Kanarina Shehu

Fjolla Bajraktari

internship@advocacy-center.org



Ky raport u mundesua nga kontributi i stafit të ATRC-së, përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e ATRC-së. Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2011, ATRC-Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, Prishtinë - Kosovë Raporti Vjetor 2012 i ATRC-së është përgaditur nga stafi i ATRC-së dhe dizajnuar nga Arsim Kosumi.

ANNUAL REPORT 2012

CONTENTS

CONTENTS

| | |
|--|----|
| A Letter from the Executive Director | 3 |
| About ATRC | 4 |
| Mission | 5 |
| Partners | 6 |
| Supporters | 7 |
| The program for training and capacity building | 8 |
| Individual consultancies | 9 |
| Program for management of grants | 10 |
| Advocacy program | 11 |
| Monitoring of returning the displaced from the third countries process..... | 12 |
